



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok

Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

5

Procesverbal

Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	19.07.2018, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Prosesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare për punë të Kuvendit të Komunës
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Haki Podrimaj, Besa Ferati, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardit Idrizaj, Ajshe Metaj.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjera:	Nënkyetari Lulzim Blakaj, Hazbi Bajra, Hysni Maxharaj, Isä Hoxha, Hazbi Bajra, Fitim Nuhiu dhe Hysena Pelaj OSBE, Lulzim Shoshi, Enver Rugova, Jeta Balaj,

Rendi i ditës:

- Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- Shqyrtimi i raportit finansiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2018.
- Shqyrtimi i raportit për 6 mujorin e punës së Kryetarit të Komunës,
- Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm dhe miratimi i Planit të Veprimit për elemimin e të metave të rekomanuara nga Auditori i Përgjithshëm;
- Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për tatimin në pronë
- Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore.
- Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.

Diskutimet:

Kryesuesi – z. Qaush Balaj - përshëndet Nënkyetarin z. Lulzim Blakaj, anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtoret e Komunës, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje.

Duke pasur parasysh se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes se Komitetit për Politikë e Financa.

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje.

Ajshe Metaj PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, thekson që materiali nuk ka ardhur me kohë dhe nuk ka mundur ta përpunoj për mbledhje.

Zenel Shatri LDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, thekson që pasi buxheti është ndarë për blerjen e lloaptopve pse nuk po ua sigurojnë lloptopoet anëtareve të Kuvendit pasi që ju duhen.

Nënkyetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron për blerjen e teknologjis informative se janë në procedura të tenderimi, dhe sqaron se të gjithë anëtaret e Kuvendit do të pajisen me i-mella zyrtare.

Kryesuesi - Hedhe në votim rëndin e ditës. Kush është për miratim?

Konstatojmë se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje.

Vendimet:

Miratohet rendi i ditës nga KPF-së pa vërejtje

Personat përgjegjës për zbatim:

Afati për zbatim:

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyete nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rrëth procesverbalit.

Pasi që nuk partë diskutime

Procesverbalni hidhet në miratim:

Vendimet:

Miratohet Procesverbal nga mbledhja e kaluar pa vërejtje,

Personat përgjegjës për zbatim:

Afati për zbatim:

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit financier për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2018.

Osmon Sadikaj, zyrtar kryesor financier – përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit financier për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2018.

Ajshe Metaj, PDK – të shpenzimet së pari duhet të behet planifikimi i mjeteve pastaj alokimi i tyre.

Osmon Sadikaj – me 30 shtator përfundon buxheti shkon në qeveri dhe hynë në ligj, kemi burime nga donacionet nga organizatat e ndryshme.

Alokimi për paga bëhet çdo muaj bëhet, çdo drejtori ka buxhetin e vet dhe planifikimet e veta për projekte.

Ajshe Metaj, PDK – a janë këto mjete të vitit 2017 apo të vitit 2018.

Eliot Kukiqi, AAK – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që të ketë një person për drejtimin e palëve në vendet e duhura për problemet e natyrave të ndryshme të cilat i kanë qytetaret dhe nuk din ku të drejtohen e enden sa një dere sa një dere.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk kalojmë në pikën tjetër

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, KPF–ja vendosi: që Shqyrtimi i raportit finansiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2018, dhe e njëjtë i kalohet Kuvendit për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Shqyrtimi i raportit për 6 mujorin e punës së Kryetarit të Komunës,

Nënkyetari i Komunës – prezanton dhe sqaron Raportin e punës së Ndërmarrjes publike lokale “Ambienti” në Istog për vitin 2017.

Ajshe Metaj, PDK – a ka pasur ndonjë pa rregullsi në aditimin e brendshëm.

Nënkyetari i Komunës – auditori i brendshëm kryen auditimin dhe ja dorëzon kryetarit ki i propozon të gjeturat.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk kalojmë në pikën tjetër

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që të miratohet Shqyrtimi i raportit për 6 mujorin e punës së Kryetarit të Komunës, dhe e njëjtë i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm dhe miratimi i Planit të Veprimit për eliminimin e të metave të rekomanduara nga Auditori i Përgjithshëm,

Nënkyetari i Komunës – bene prezantimin dhe sqarimin e Raportit të Auditorit të Përgjithshëm dhe miratimi i Planit të Veprimit për eliminimin e të metave të rekomanduara nga Auditori i Përgjithshëm,

Ajshe Metaj, PDK – të dhënat janë të publikuara nuk ka shumë të gjetura, për paga dhe mëditje a ekziston ajo e gjete, disa parcela që kanë mbetur pa u regjistruar.

Nënkyetari i Komunës - të mallrat dhe shërbimet janë gabim ato mjete të mbeturat të destinohen në mallrat dhe shërbimet, pronat në zyrën kadastrale janë të regjistruarat të gjitha parcelat me titull.

Eliot Kukiqi, AAK – menaxhimi jo adekuat i pronave komunale me qira 36 persona nuk kanë inkasuar mjetë për pronat që i shfrytëzojnë.

Nënkyetari i Komunës - Në 2017 egziston një shpatinë ligjore të pronat ku afatet janë në afatshkurterat nga 1 vit deri në 15 vite ndërsa afatgjatë nga 15 vite deri në 99 vite, ka kontrata për 9 muaj, e kemi punuar një strategji i për borxhe, këtë vit nuk kemi lidhur as një kontratë ende, do ti ndjekim procedurat ligjore.

Zenel Shatri LDK – në raport shkruan qartë çka është gjetur dhe si duhet të eliminohen këto të gjetura.

Hysni Maxharraj – ne kemi punuar planin e veprimit për eliminimin e të gjeturave dhe në bazë të këtijë plani do të eliminohen këto të gjetura.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që miratohet një zëri Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm dhe miratimi i Planit të Veprimit për eleminimin e të metave të rekomanduara nga Auditori i Përgjithshëm, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5	

Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e pestë e rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për tatimin në pronë

Hysni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa – bene prezantimin dhe sqarimin e Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për tatimin në pronë

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që të miratoj një zëri Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për tatimin në pronë, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 6	

Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e gjashtë e rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në

institucionet Edukativo-Arsimore.

Hajrush Shoshi, Drejtor për Arsim -bene prezantimin dhe sqarimin e Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore.

Zenel Shatri, LDK – pyetë klasa e parë i ka tre mesuesë kush duhet të mbes pa unë, të rregullohet me rregullore kjo.

Nënkyetari i Komunës – niveli qendror i rregullon këto kriteret.

Hajrush Shoshi – numri i nxensve ka renje dhe për ata po ka msuesë teper, do mundohemi që mos ti largojm nga puna, ata që do të dalin në pension nuk do të zevendsohohen.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet me një votë abstenim.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që miratohet Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullorës për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore, dhe e njëjta i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7

Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës, Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.
hedh në miratim.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: miratohet Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019, dhe e njëjta i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 8

Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i transferit të mjeteve buxhetore nga viti 2018.

Hysni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa -bene prezantimin dhe sqarimin e Shqyrtimi dhe miratimi i transferit të mjeteve buxhetore nga viti 2018

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që miratohet Shqyrtimi dhe miratimi i transferit të mjeteve buxhetore nga viti 2018, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

DISKUTIME

Kryesuesi – para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezentë ishin të gjithë anëtar e Komitetit për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje.

Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 12.00